
	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>fage 1 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>


PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT

Nëntor 2014


	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>fage 2 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

Përmbajtja

1. QËLLIMI	4
1.1. Obligimet Ligjore	4
2. FUSHA E ZBATIMIT.....	4
2.1. Procesi nga Aplikimi për Kyçje deri në futje në operim	4
2.2. Aplikimi	4
3. PËRCAKTIMI I TERMAVE	4
4. LIDHSHMËRIA ME DOKUMENTE TJERA.....	6
5. PËRSHKRIMI I PROCEDURËS	6
5.1. Procesi i Ofertës për Kyçje.....	6
5.1.1. Aplikimi dhe Pranimi i Aplikacionit	9
5.1.2. Studimet e para-fizibilitetit	10
5.1.3. Kyçjet Komplekse.....	10
5.1.4. Oferta për Kyçje	11
5.1.5. Procesi i shqyrtimit të aplikacionit	11
5.1.6. Shqyrtimi i Ofertës për Kyçje	14
5.1.7. Validiteti i Ofertës për Kyçje	14
5.1.8. Nënshkrimi i Marrëveshjes për Kyçje	14
5.2. Ndryshimi i Aplikacionit.....	15
5.2.1. Ndryshimi gjatë procesit të aplikimit	15
5.2.2. Ndryshimi i Ofertës për Kyçje.....	15
5.2.3. Zgjatja e Ofertës.....	16
5.2.4. Tërheqja e aplikacionit.....	16
5.2.5. Konfidencialiteti.....	16
5.3. Procesi i Taksës për Kyçje.....	17
5.3.1. Taksa për Aplikim.....	17
5.3.2. Taksa e Kyçjes	17
5.4. Sigurimi i të dhënave planifikuese.....	17

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>fage 3 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

5.5. Procesi i ndërtimit dhe i mbikëqyrjes.....	17
5.6. Komisionimi dhe vënia në punë e pikës kyçëse.....	18
6. FORMULARËT/DOKUMENTET.....	18
6.1. Burimet	18
6.2 Dokumentet dhe formularët	19
7. ANEKSET	20
7.1. Lista e shpërndarjes	20
7.2. Shënimet për versionet.....	20

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 4 nga 20</i>
<i>Departamentit për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

1. QËLLIMI

1.1. Obligimet Ligjore

KOSTT në bazë të kërkesave ligjore që dalin nga legjislacioni sekondar të aprovuara nga **Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRÉ)**, obligimi nga dokumenti „Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji” obligohet që në përputhje të plotë me këtë rregullë të përgatit dhe dërgoj për aprovim në **ZRRÉ** Procedurat për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit.

2. FUSHA E ZBATIMIT

2.1. Procesi nga aplikimi për kyçje deri në futje në operim

Ky dokument përfshinë një mori çështjesh/procedurash që palët do t'i zbatojnë gjatë procesit të aplikimit për kyçje, njëherësh ky dokument në formë të detajuar përcakton të gjithë hapat përkatës që duhet të ndërmerren, që nga aplikimi e deri në operim të pikës kyçëse duke përfshirë proceset rregullative, tarifore, studimore, planifikuese, etj. Ky dokument është përpiluar në atë mënyrë që të sigurojë transparencë dhe jo-diskriminim për të gjitha palët që dëshirojnë të kyçen në rrjetin e transmisionit.


2.2. Aplikimi

Këto procedura aplikohen tek të gjitha palët që do të kyçen në sistemin e transmisionit:

- a) Gjeneruesit
- b) Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes
- c) Konsumatorët

3. PËRCAKTIMI I TERMAVE

Aplikacioni për Kyçje është aplikacion i dorëzuar nga **Aplikuesi** për një kyçje të re apo rritje të kapacitetit të kyçjes së vjetër në Rrjetin e Transmisionit.

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 5 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

Aplikuesi është pala ose pala e mundshme që është e interesuar, ka aplikuar ose është në proces të kyçjes në rrjetin e transmisionit.

Formulari i Aplikacionit për Kyçje është formë e aplikacionit për kyçje për gjenerator, ngarkesë, respektivisht konsumator sikurse paraqitet në Shtojcën 2 të Metodologjisë së Taksave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit.

KOSTT nënkupton Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës.

Marrëveshja për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit është një marrëveshje dypalëshe ndërmjet **KOSTT** dhe një **Aplikuesi** që detajon kushtet për kyçje në sistemin e transmisionit.

Oferta për Kyçje është një ofertë për kyçje në Rrjetin e Transmisionit e dhënë nga **KOSTT** për palën aplikuese.


Studimi i Dizajnit paraqet një analizë të detajuar mbi mundësitë (opsionet) e kyçjes në rrjetin e transmisionit, të përgatitur nga **KOSTT** për një **Aplikues** pas dorëzimit të **Aplikacionit për Kyçje** nga ana e **Aplikuesit**.

Studimi i Fizibilitetit është studim i detajuar mbi çështjet teknike dhe ekonomike bazuar në kalkulimet teknike të projektit të caktuar. Ky studim do të realizohet nga një palë e kontraktuar për shkak të madhësisë dhe kompleksitetit të projektit.

Taksa për Aplikim është pagesa që kryhet në kohën kur aplikohet për kyçje, e cila mbulon shpenzimet për: **Studimin e Dizajnit** dhe/ose **Studimin e Fizibilitetit**, **Ofertën për Kyçje** dhe draftimin e **Marrëveshjes për Kyçje**. Gjatë diskutimeve fillestare me **Aplikuesin** para se të bëhet Aplikimi për Kyçje, **KOSTT** do të përcakton numrin e ditëve të nevojshme për procedimin e Aplikacionit.

Taksa për kyçje nënkupton të gjitha ato taksa të përshkruara në dokumentin Metodologjia e Taksave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit

ZRrE nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 6 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

4. LIDHSHMËRIA ME DOKUMENTE TJERA

Ky dokument është hartuar në përputhshmëri të plotë sipas kërkesave që dalin nga dokumentet:


- a) Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji,
- b) Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit,
- c) Kodi i Rrjetit

5. PËRSHKRIMI I PROCEDURËS

5.1. Procesi i Ofertës për Kyçje

Procesi i **Ofertës për Kyçje** është proces që fillon me dorëzimin e **Aplikacionit për Kyçje** nga **Aplikuesi** që dëshiron të realizojë kyçjen në rrjetin e transmisionit dhe përfundon me nënshkrimin e **Marrëveshjes për Kyçje** ndërmjet **KOSTT** dhe **Aplikuesit**.

Në vijim në formë diagrami është paraqitur procedura e shqyrtimit të një **Aplikacioni për Kyçje**.

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>fage 7 nga 20</i>
<i>Departamentit për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>






Fig. 1 Procedurat e aplikimit për kyçje në rrjetin e transmisionit

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 8 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

Numërimi i ditëve fillon me dorëzimin e **Aplikacionit për Kyçje** nga **Aplikuesi në KOSTT**, kështu që periudha nga aplikimi për kyçje deri tek nënshkrimi i **Marrëveshjes për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit** e paraqitur në figurën 1 ndahet në:

- **Dita 0**
 - **Aplikuesi**, e dorëzon **Aplikacionin për Kyçje** së bashku me dëshminë e pagesës përmes postës apo direkt në Zyrën e Arkivës në **KOSTT**, (nëse aplikacioni dorëzohet përmes postës numërimi i ditëve fillon kur **KOSTT** pranon aplikacionin).
- **Dita 1-30**
 - **KOSTT** analizon dhe nxjerr përfundimet nëse kyçja e paraparë sipas **Aplikacionit për Kyçje** është (apo nuk është) e mundshme teknikisht dhe ekonomikisht dhe në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit, i plotëson kushtet dhe nuk paraqet ndonjë problem në sigurinë e operimit të Sistemit të Transmisionit. **KOSTT**-i në bazë të analizave do të përgatit dhe dërgon tek **Aplikuesi** njoftimin mbi mundësinë apo jo të kyçjes në Rrjetin e Transmisionit.
- **Dita 31-90**
 - **KOSTT** përgatit **Ofertën për Kyçje** të cilën e dërgon tek **Aplikuesi** së bashku me draft **Marrëveshjen për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit**.
- **Dita 91-120**
 - **Aplikuesi** e shqyrton **Ofertën për Kyçje** në rrjetin e transmisionit të dërguar nga **KOSTT** të cilën mund ta nënshkruajnë.

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 9 nga 20</i>
<i>Departamentit për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

- **Dita 121-150**
 - **Aplikuesi dhe KOSTT** shqyrtojnë/negociojnë dhe nënshkruajnë **Marrëveshjen për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit.**


5.1.1. Aplikimi dhe Pranimi i Aplikacionit

Në fazën fillestare **Aplikuesi** duhet ta informojë **KOSTT**-in lidhur me të dhënat e planifikimit paraprak të projektit, të dhënat i mundësojnë **KOSTT**-it për të vlerësuar gjendjen aktuale në sistemin e transmisionit, konkretisht mundësinë e transferimit të energjisë që do të duhej të jetë e përballueshme për sistemin e transmisionit.

Aplikuesi duhet fillimisht nga faqja elektronike zyrtare e **KOSTT**-it të sigurojë/posedoj **Aplikacionin/Formularin për Kyçje. Aplikacioni për Kyçje** i plotësuar së bashku me dëshminë e pagesës së **Taksës për Aplikim** dorëzohet në Zyrën e Arkivës së **KOSTT**-it, që mbulon shpenzimet për: **Studimin e Dizajnit dhe/ose Studimin e Fizibilitetit, Ofertën për Kyçje dhe draftimin e Marrëveshjes për Kyçje.**

Pas pranimit të Aplikacionit për Kyçje dhe në rast se **KOSTT** konstaton që **Aplikacionit për Kyçje** i mungojnë të dhënat përkatëse, **KOSTT** së bashku me **Aplikuesin** i shqyrtojnë të dhënat lidhur me aplikimin. **Aplikuesi** pas konsultimeve me **KOSTT**-in dhe pasi ka plotësuar në mënyrën adekuate **Aplikacionin për Kyçje** e ri-dërgon atë në zyrën përkatëse në **KOSTT**.

Rinumërimi i ditëve ri-fillon në momentin kur **KOSTT** e ri-merr formularin e ri-plotësuar.

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 10 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

KOSTT brenda afatit kohor të dhënë në Metodologjinë e Taksave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit duhet që në formë të shkruar ta informojë palën aplikuese lidhur me **Ofertën për Kyçje**.


5.1.2. Studimet e para-fizibilitetit

Duke u referuar Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit dhe Kodin e Rrjetit – Kodi i Kyçjes, palët kanë mundësi që para dorëzimit të **Aplikacionit për Kyçje** të konsultohen me zyrtarët përkatës brenda **KOSTT**-it lidhur me opsionet e projekt planit. Ky shërbim nuk është i detyrueshëm dhe si i tillë do të jepet pa pagesë nga **KOSTT**-i. Nëse **Aplikuesi** kërkon shënime më të detajuara duke përfshirë edhe një vlerësim preliminar (me vlera të përafërta) të koston së projektit apo një studim më të hollësishëm të projektit atëherë është e drejtë legjitime e **KOSTT**-it që për të dhënat shtesë të kërkoj pagesë.

5.1.3. Kyçjet Komplekse

Aplikuesi duhet ta ketë të qartë që **KOSTT** sipas dispozitave nga **Kodi i Rrjetit** - Kodi i Kyçjes mund ta emëron një aplikim për kyçje si kyçje komplekse për të cilën brenda 30 ditëve nga aplikimi formal **KOSTT**-i në formë të shkruar do ta informoj **Aplikuesin** lidhur me vendimin që aplikimi përkatës ka të bëjë me kyçje komplekse.

Nëse aplikacioni hyn në kategorinë e kyçjeve komplekse atëherë në këto raste studimi duhet të përfundohet brenda nëntëdhjetë (90) ditësh kalendarike prej ditës së dorëzimit të **Aplikacionit për Kyçje**, dhe **Oferta për Kyçje** duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike prej përfundimit të studimit përkatës.

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 11 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

5.1.4. Oferta për Kyçje

KOSTT në pajtueshmëri me Metodologjinë e Taksave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit dhe në bazë të rezultateve tenderuese përgatit **Ofertën për Kyçje**.

5.1.5. Procesi i shqyrtimit të aplikacionit

Në fig.2 është paraqitur procesi intern në **KOSTT** për shqyrtimin e ndikimit të kyçjes (sipas të dhënave në **Aplikacionin për Kyçje**) në sigurinë e operimit të sistemit të transmisionit.



PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT

PR-MP-001

ver. 1.1

faqe 12 nga 20

Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe
Inxhinieri

Sektori: Zhvillimi i Rrjetit





Figura 2 Procesi i shqyrtimit të Aplikacionit për Kyçje

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 13 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

Dita 0 – Aplikuesi e dërgon aplikacionin së bashku me dëshminë e pagesës në Zyrën e Arkivës në KOSTT;

Dita 1 - Zyra e Arkivës e pranon aplikacionin dhe dëshminë e pagesës nga **Aplikuesi** dhe e dërgon tek Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it;


Dita 2 - Kryeshefi Ekzekutiv i **KOSTT**-it e shqyrton aplikacionin dhe e dërgon tek Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri (DMP&I) për analizë të mëtutjeshme;

Dita 3-5 - DMP&I e shqyrton **Aplikacionin për Kyçje** nëse është i tëri në formë të rregullt i plotësuar, nëse **Aplikacionin për Kyçje** nuk i përmban të dhënat e plota për një analizë përkatëse, atëherë DMP&I e kthen tek **Aplikuesi** për ri-plotësim. Nëse **Aplikacioni për Kyçje** i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme atëherë ai dërgohet për analizë tek Zyra për Zhvillim dhe Planifikim Afatgjatë;

Dita 6-25 - Zyra për Zhvillim dhe Planifikim Afatgjatë përgatit rezultatet e nxjerra nga softueri përkatës dhe i dërgon tek DMP&I.

Nëse Zyra për Zhvillim dhe Planifikim Afatgjatë konstaton që për një projekt të tillë nevojitet **Studim i Fizibilitetit**, atëherë **KOSTT** njofton **Aplikuesin** për kompleksitetin e projektit dhe nevojën për kryerjen e një **Studimi të Fizibilitetit**. **Aplikuesi** shqyrton njoftimin dhe ri-aplikon për kyçje në rrjetin e transmisionit, ndërsa **KOSTT** përmes procedurave tenderuese në bashkëpunim me aplikuesin përzgjedhë kompaninë përkatëse për **Studim të Fizibilitetit**;

Dita 25-30 - Në bazë të rekomandimeve nga Zyra për Zhvillim dhe Planifikim Afatgjatë se një kyçje e tillë nuk paraqet pengesë në sigurinë e operimit të sistemit të transmisionit, atëherë DMP&I përgatit dhe e dërgon tek **Aplikuesi** njoftimin mbi vazhdimin e shqyrtimit dhe përgatitjes së **Ofertës për Kyçje**.

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 14 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

Nëse Zyra për Zhvillim dhe Planifikim Afatgjatë konstaton që një kyçje e tillë e rrezikon Sistemin e Transmisionit atëherë DMP&I në formë të shkruar e informon **Aplikuesin** rreth pamundësisë për të realizuar një kyçje të tillë.

5.1.6. Shqyrtimi i Ofertës për Kyçje

Aplikuesi që nga momenti i pranimit të **Ofertës për Kyçje** nga **KOSTT**, duhet që brenda 30 ditëve ta nënshkruaj **Ofertën për Kyçje** dhe të dërgoj në **KOSTT**.

Aplikuesi ka të drejtën që me stafin përkatës në **KOSTT** të shqyrtojë **Ofertën për Kyçje**, për të cilën **Aplikuesi** mendon se duhet të ketë qartësi më të detajuar, apo mendon që çmimi i **Ofertës për Kyçje** nuk përkon me realitetin.

Nëse gjatë shqyrtimit të **Ofertës për Kyçje**, **KOSTT** dhe **Aplikuesi** janë të mendimit për ndryshime eventuale, atëherë **Aplikuesi** e ri-dërgon në **KOSTT** të ri-plotësuar **Aplikacionin për Kyçje**.


Ri-numërimi i ditëve rifillon në momentin kur **KOSTT** e ri-merr **Aplikacionin për Kyçje** të ri-plotësuar.

5.1.7. Validiteti i Ofertës për Kyçje

Oferta për Kyçje do të jetë e plotëfuqishme për afatin kohor të definuar në Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit dhe numërimi i ditëve fillon që nga dita kur **Aplikuesi** ka pranuar **Ofertën për Kyçje**.

5.1.8. Nënshkrimi i Marrëveshjes për Kyçje

Aplikuesi dhe **KOSTT** brenda periudhës 30 ditore nga dita e nënshkrimit të **Ofertës për Kyçje** duhet që të nënshkruajnë **Marrëveshjen për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit**.

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 15 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

5.2. Ndryshimi i Aplikacionit

5.2.1. Ndryshimi gjatë procesit të aplikimit


Nëse **Aplikuesi** mendon se **Aplikacioni për Kyçje** duhet të pësoj ndryshime derisa ai është në proces të shqyrtimit nga **KOSTT**, atëherë **Aplikuesi** do ta informojë **KOSTT**-in për ndryshimet që dëshiron t'i realizojë në mënyrë që t'ia mundësoj **KOSTT**-it të analizojë ndryshimet dhe të bëjë përfshirjen e tyre në aplikacionin bazë. Ndërsa për ndryshimet që do të përfshihen në aplikacionin bazë dhe që kanë të bëjnë me ndryshim të **Studimit të Dizajnit, Studimin e Fizibilitetit**, gjegjësisht ndryshim të kapacitetit të pikës së kyçjes, **Aplikuesi** do të zbatojë procesin e ri-aplikimit.

KOSTT do ta informoj **Aplikuesin** nëse propozimet për ndryshime janë marrë parasysh dhe nëse vlerësohet se duhet të zbatohet procesi i ri-aplikimit, atëherë **KOSTT** do ta faturojë **Aplikuesin** me një faturë për ndryshimin e kërkuar për aplikim për kyçje dhe vlera e faturës do të përcaktohet sipas dispozitave të Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit (Shtojca 3).

Aplikuesi pas posedimit/marrjes së faturës për ndryshime ka në dispozicion 5 ditë pune për të vendosur nëse do të vazhdoj me ndryshim të **Aplikacionit për Kyçje** ose jo. Nëse **Aplikuesi** vendos që të vazhdohet pa ndryshime shtesë atëherë **KOSTT** do të vazhdoj procesin me aplikacionin bazë duke ju përmbajtur rregullave të defnuara me rregullativën përkatëse.

5.2.2. Ndryshimi i Ofertës për Kyçje

Nëse një **Ofertë për Kyçje** lëshohet nga **KOSTT** për **Aplikuesin** dhe në ndërkohë **Aplikuesi** kërkon ndryshim të **Ofertës për Kyçje**, **KOSTT** do të analizojë ndryshimet e kërkuara nga **Aplikuesi** dhe do ti përfshijë ato në **Ofertën për Kyçje**, vetëm atëherë kur këto ndryshime nuk kanë të bëjnë me ndryshim të **Studimit të Dizajnit, Studimin e**

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 16 nga 20</i>
<i>Departamentit për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

Fizibilitetit, gjegjësisht ndryshim të kapacitetit të pikës së kyçjes në të cilat raste **Aplikuesi** do të zbatojë procesin e ri-aplikimit.

Në rastet kur zbatohet procesi i ri-aplikimit atëherë **KOSTT-i** do ta faturojë **Aplikuesin** me një faturë për ndryshimin e kërkuar për aplikim për kyçje, dhe vlera e faturës do të përcaktohet sipas dispozitave të Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit (Shtojca 3).

5.2.3. Zgjatja e Ofertës


Zgjatja e kohës për dorëzimin e **Ofertës për Kyçje** mund të bëhet vetëm atëherë kur për një gjë të tillë pajtohen të dy palët **KOSTT** dhe **Aplikuesi**. Nëse **Ofertës për Kyçje** i ka skaduar afati atëherë **Aplikuesit** nuk mund ti garantohet një zgjatje e tillë.

5.2.4. Tërheqja e aplikacionit

Nëse një **Aplikacion për Kyçje** është në proces të shqyrtimit, me kërkesë të **Aplikuesit** mund të bëhet tërheqja e **Aplikacionit për Kyçje**. **Aplikuesi** do të detyrohet të paguaj taksë vetëm për ditët sa **KOSTT** ka qenë i kyçur në shqyrtimin e **Aplikacionit për Kyçje**.

5.2.5. Konfidencialiteti

Të gjitha diskutimet ndërmjet një **Aplikuesi** dhe **KOSTT-it** janë tërësisht konfidenciale. **KOSTT-i** nuk do të diskutoj çështjet me palët e treta përveç nëse merr leje me shkrim nga **Aplikuesi**.

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 17 nga 20</i>
<i>Departamentit për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

KOSTT dhe **Aplikuesi** do të nënshkruajnë një marrëveshje mbi konfidencialitetin, brenda së cilës vendosen rregullat strikte mbi konfidencialitetin e bisedave dhe dokumenteve përkatëse.

5.3. Procesi i Taksës për Kyçje

5.3.1. Taksa për Aplikim

Taksa për Aplikim do të paguhet nga **Aplikuesi** sipas dispozitave të dalura nga Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit.

5.3.2. Taksa e Kyçjes


Taksa e Kyçjes do të përmbajë komponentët sipas përshkrimeve në dokumentin Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit.

5.4. Sigurimi i të dhënave planifikuese

Aplikuesi duhet që brenda 30 ditëve pasi të nënshkruaj **Marrëveshjen për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit** t'i dërgoj në **KOSTT** të gjitha të dhënat e detajuara siç kërkohet nga Kodi i Rrjetit konkretisht Kodi i Planifikimit.

5.5. Procesi i ndërtimit dhe i mbikëqyrjes

Përgjegjësitë në mes të **KOSTT** dhe **Aplikuesit** do të realizohen dispozitave të përshkruara në dokumentin Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit.

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 18 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

5.6. Komisionimi dhe vënia në punë e pikës kyçëse

Aplikuesi në prezencën e **KOSTT**-it është i detyruar të kryej të gjitha testimet dhe të përgatit çertifikatën e testimit, me të cilën dëshmon që pajisjet elektroenergjetike i përmbushin të gjitha standardet relevante që aktualisht janë në fuqi.

Aplikuesi duhet t'i konfirmoj **KOSTT**-it se të gjitha testimet janë kryer me sukses dhe që të gjitha pajisjet elektroenergjetike janë në përputhshmëri të plotë me standardet relevante. **KOSTT** merr përgjegjësinë për aprovimin e atyre testeve. Pasi që të gjitha testimet janë aprovuar nga **KOSTT** dhe pasi që janë zbatuar të gjitha dispozitat e parapara me **Kodin e Kyçjes**, atëherë **KOSTT** detyrohet që brenda 7 ditëve ta kyçë nën tension pikën kyçëse.


6. FORMULARËT/DOKUMENTET

6.1. Burimet

Nr.	Emri i dokumentit
1.	1. Rregulli për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji 2. Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit 3. Kodi i Rrjetit

Të dhënat kontaktuese

Aplikuesit e interesuar për mundësitë e eksplorimit duhet të konsultoj ueb-faqen zyrtare të **KOSTT** (www.kostt.com)

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 19 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

Për informata shtesë personi kontaktues:

Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri-KOSTT

Tel: +381 (0) 38 501 301 041

E-mail: shpresa.krasniqi@kostt.com

6.2 Dokumentet dhe formularët

Aplikacioni për kyçje

Aplikuesi i interesuar për tu kyçur në rrjetin e transmisionit duhet të kompletoj:

- a) Aplikacionin për kyçje,
- b) Pagesën për aplikacionin fillestar

Dokumentacioni i kompletuar mund të dërgohet:

- a) Përmes postës në adresën


KOSTT

Rr. Iljaz Kodra p.n

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

- b) Drejtpërdrejtë në Zyrën e Arkivës së **KOSTT**-it

	PROCEDURAT PËR KYÇJE NË RRJETIN E TRANSMISIONIT	PR-MP-001
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 20 nga 20</i>
<i>Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri</i>		<i>Sektori: Zhvillimi i Rrjetit</i>

7. ANEKSET

7.1. Lista e shpërndarjes

Nr.	Emri dhe mbiemri	Data	Nënshkrimi
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			
8.			
9.			
10.			

7.2. Shënimet për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.11		Versioni Inicial	5 Vite
1.2	02.07.2013	Versioni i ndryshuar	5 vite